



PROPOZIM

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6), në lidhje me nenin 17, paragrafi (4) nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21) dhe neni 172, paragrafi (7) nga Ligji i Shërbimeve Pagesore dhe Sistemet Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M

për kushtet dhe procedurën për hapjen dhe mbylljen e llogarive pagesore në Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

I. Terme të përgjithshme

1. Me këtë vendim përshkruhen kushtet dhe procedura për hapjen dhe mbylljen e llogarive pagesore në Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: Banka Popullore).

II. HAPJA E LLOGARIVE

2. Banka Popullore hap llogaritë pagesore nga pika 1) e këtij vendimi në bazë të kërkesës me shkrim për hapjen e llogarisë pagesore në pajtim me formularin "Kërkesë për hapje të llogarisë pagesore" (shtojca 1 e këtij vendim) dhe kontrata e lidhur mes personit juridik dhe Bankës Popullore në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore (në tekstin në vijim: Ligji).

3. Para se të hapet llogaria pagesore, Banka Popullore e identifikon dhe vërteton identitetin e personit juridik dhe personave të cilët veprojnë në emër dhe në llogari të personit juridik, në bazë të dokumentacionit në vijim:

- dokumentit për regjistrim, lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose nga shteti në të cilën është i regjistruar personi juridik, që nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë muaj dhe nga i cili mundet të vërtetohet: tituli, forma juridike, selinë, numri tatimor ose numër tjetër regjistruar të personit juridik, përfaqësues ligjor, organi drejtues ose personat e autorizuar për krijimin e një marrëdhënie biznesi, domethënë ekzekutimin e llogarisë në emër të personit juridik;

- formularit për nënshkrim të vërtetuar nga përfaqësuesi ligjor të personit juridik, i lëshuar nga ana e organit kompetent të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose nga shteti ku është i regjistruar personi juridik;
- formularit "Paraqitja e personave të autorizuar për disponim e parave të gatshme të llogarisë pagesore" (shtojca 2 e këtij vendimi) në pajtim me të dhënat nga dokumenti zyrtar për identifikimin personal të personave të cilët janë të autorizuar për disponim të parave në llogarinë pagesore dhe egzemplar nga nënshkrimi i tyre sipas formularit "Lista e nënshkrimeve të depozituara" (shtojca 3 e këtij vendimi), të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik.

Krahas dokumenteve nga paragrafi (1) i kësaj kjo pike, nëse personi fizik i cili është në strukturën e udhëheqjes të personit juridik ose është person i autorizuar për disponimin e parave të gatshme nga llogaria pagesore në të njëjtën kohë është edhe bartës i funksionit publik, dorëzon deklaratë të nënshkruar nga vetë dora e tij për bartjen e funksionit publik në pajtueshmëri me formularin "Deklaratë për bartjen e funksionit publik" (shtojca 4 e këtij vendimi).

4. Gjatë hapjes së llogarisë pagesore të personit juridik, Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë për të cilën do të jëtë i njoftuar paraprakisht personi juridik i cili ka qëllim të hap llogari pagesore.

5. Dokumentacioni që dorëzohet ndaj kërkesës të pikave 3) dhe 4) të këtij vendimi duhet të jetë original ose kopje e vërtetuar sipas rregulloreve (nga noteri ose organ tjetër kompetent shtetëror në të cilën është i regjistruar personi juridik), i nënshkruar nga personi i autorizuar, ose, organi përkatës kompetent, ose, i nënshkruar në mënyrë elektronike sipas rregullores me të cilat rregullohen dokumentacionet elektronike, identifikimet elektronike dhe shërbimet konfidenciale.

Përderisa dokumentacioni që i referohet kërkesës nga pikat 3) dhe 4) të këtij vendimi është në gjuhë tjetër, bashkë me origjinalin dorëzohet edhe përkthim në gjuhën maqedonase, vërtetuar nga përkthyes gjyqësor i autorizuar.

6. Banka Popullore mund t'iu hap llogari pagesore institucioneve financiare ndërkombëtare pa lëshuar kërkesë dhe dokumentacionin nga pikat 3), 4) dhe 5) të këtij vendimi dhe pa lidhje kontraktuale, përderisa është e përcaktuar si depozitare e tyre në pajtueshmëri me ligjin.

7. Personi juridik është i detyruar të bëjë përditësimin e dokumentacionit të pranuar nga pikat 3) dhe 4) nga ky vendim pas çdo ndryshimi të bërë, jo më vonë se tre ditë pune nga dita e bërjes së ndryshimeve, ndërsa rregullisht në çdo 5 vjet, si dhe në periudhë më të shkurtër me kërkesë të Bankës Popullore.

Banka Popullore i zbaton ndryshimet në dokumentacion nga pikat 3) dhe 4) e këtij vendimi nga momenti kur për të ka lajmërim në formë të shkruar nga ana e personit juridik dhe/ose personit i cili vepron në emër të tij dhe për llogarinë e tij.

III. MBYLLJA E LLOGARIVE

8. Banka Popullore mbyll llogarinë pagesore të personit juridik në bazë të kërkesës së tij në formë të shkruar të përcaktuar në formularin “Kërkesë për mbylljen e llogarisë pagesore” (shtojca 5 e këtij vendimi), përderisa plotësohen kushtet e caktuara në Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Sistemet Pagesore dhe ligj tjetër.

9. Banka Popullore mbyll llogarinë pagesore të personit juridik edhe pa kërkesën e tij me shkrim nëse personi juridik:

- është subjekt joaktiv, fshirja e të cilit është i publikuar në ueb faqen e Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtueshmëri me ligjin;
- ndalon së ekzistuari si subjekt juridik në bazë të ligjit, vendimit ligjor, ndryshimit në status ose me urdhër të organeve kompetente;
- cënon detyrimet kontraktuale, për atë shkak Banka popullore ndërpret kontratën për hapjen e llogarisë pagesore.

10. Pas mbylljes së llogarisë pagesore, Banka popullore i kthen paratë e mbetura në llogarinë pagesore pas mbylljes personit juridik, pasardhësit ligjor ose personit juridik të përcaktuar me ligj ose me ndonjë rregullore tjetër.

Në qoftë se me ligj ose me rregullore tjetër nuk është përcaktuar pasardhësi ose personi tjetër juridik në llogarinë e të cilit duhet të kthehen paratë, Banka Popullore i kalon paratë nga llogaritë pagesore të mbyllura në llogarin evidenciale tek Banka Çopullore synuar për paratë e gatëshme të cilat nuk përdoren. Banka Popullore për këtë duhet të njoftojë personin juridik që paraprakisht ka qenë i autorizuar të disponojë më paratë nga llogaria e mbyllur, në afat prej tri ditëve llogaritur nga dita e mbylljes e llogarisë pagesore.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

11. Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi ndërpritet së vlejtori Vendimi për kushtet e përgjithëshme për hapjen dhe mbylljen e llogarive në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 3/22).

12. Ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2023.

O Nr. 02-15/XXII-12/2022
28.12.2022
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

SHTOJCA NR.1**KËRKESË PËR HAPJEN E
LLOGARISË PAGESORE**

I.Të dhënat e personit juridik:	
Emri i personit juridik	
Adresa e personit juridik (vendi, rruga dhe numri)	
NVAS i personit juridik	
Numri tatimor i personit juridik	
Emri dhe mbiemri, telefoni dhe posta elektronike për kontakt	

II.Kërkesa për hapjen e :
☐ Llogarisë pagesore
☐ Llogaria pagesore për projekt

Me kërkesën i dorëzoj dokumentet e nevojshme për hapjen e llogarisë, në pajtim me *Vendimin për kushtet dhe procedurën për hapjen dhe mbylljen e llogarive të shlyerjes dhe llogarive të pagesave në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

data _____ viti 20__ _____

(vulë dhe nënshkrim i përfaqësuesit ligjor të personit juridik)

III. Dokumentacioni i dorëzuar:
☐ Dokumenti i regjistrimit i lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilën personi juridik është i regjistruar
☐ Formulari për nënshkrimin e vërtetuar të përfaqësuesit ligjor të personit juridik i lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilën personi juridik është i regjistruar
☐ Paraqitja e personave të autorizuar për disponimin e mjeteve në llogarinë pagesore (shtojca 2 e vendimit)
☐ Lista e nënshkrimeve të depozituara (shtojca 3 e vendimit)
☐ Deklarata e bartësit të funksionit publik (shtojca 4 e vendimit)* <i>* të dorëzohet nëse ndonjë nga personat brenda strukturës drejtuese të personave juridik ose nga aplikimi I personave të autorizuar për disponimin e mjeteve në llogari është mbajtës I një posti publik</i>
☐ Bazuar në pëlqimin e Ministrisë së Financave për hapjen e llogarisë pagesore në valutë të huaj
☐ Marrëveshje donacioni ose kredie ** <i>**paraqitet për hapjen e një llogarise pagesorë në valutë të huaj për projekt</i>
☐ Prova të tjera:

Kërkesa dorëzohet në dy kopje.

Formulari: BPRMV

SHTOJCA NR. 2

REGJISTRIM TË PERSONAVE TË AUTORIZUAR TË DISPONIM TË PARAVE NE LLOGARINË PAGESORE

I. Të dhënat e personit juridik							
Emri I personit juridik							
Adresa e personit juridik (vendi, rruga dhe numri)							
Numri personal ose një numër tjetër regjistrimi							
Numri tatimor I personit juridik							
Emri dhe mbiemri, telefoni dhe email kontakti							
II. Nënshkruesit e autorizuar për disponimin e mjeteve në llogarinë pagesore nr.							
	Emri dhe mbiemri	Data dhe vendi I lindjes	Vendi dhe adresa e banimit/vendbanimit	Numri personal/numri I identifikimit	Nr.të një dokumenti identifikimi	E dërguara nga	Deri në
1							
2							
3							
4							
5							

Data _____ 20__ viti.

(vulë dhe nënshkrim të përfunduesit ligjor të personit juridik)

Formulari: BPRMV

SHTESA NR.3**LISTA E NËNSHKRMEVE TË DEPOZITUARA**

I. Të dhënat e personit juridik	
Emri I personit juridik	
Adresa e personit juridik (vendi, rruga dhe numri)	
Numri personal ose një numër tjetër regjistrimi	
Numri tatimor I personit juridik	
Emri dhe mbiemri, telefoni dhe email kontakti	

II. Nenshkrimet e depozitave të persoanve të autorizuar për disponimin e parave në llogarinë pagesore									
Të dhënat personale				Lloji I autorizimit				Autorizimi për	
	Emri dhe mbiemri	Numri personal/ numri I identifikimit	Nënskrim I dorëzuar me dorë	Në mënyrë të pavarur	Колективно	I kufizuar deri te	E pakufizuar	Transaksionet e pagesave hyrëse	Remitancat e transaksioneve pagesore
1									
2									
3									
4									
5									

Data_____ 20__ viti.

(Numri I listës) _____

(vula dhe nënskrimi I përfaqësuesit ligjor të personit juridik)

(vulë dhe nënskrim e personit të autorizuar në pranimin e Bankës Popullore)

Formulari: BPRMV

SHTESA 4

DEKLARATË E BARTËSIT TË FUNKSIONIT PUBLIK

Unë, (emri dhe mbiemri) me adresë banimi ne rr. (adresa e vlefshme sipas dokumentit të identifikimit), i/e lindur në..... (dita, muaji, viti I lindjes) në..... (qyteti), me numrin personal....., (te dhënat për llojin e pronësisë së perfituar) në (emri I institucionit) deklaroj se jam bartës I funksionit publik.

Nënshkrimi

SHTESA NR.5**KËRKESË PËR MBYLLJEN E LLOGARISË PAGESORE**

I. Të dhënat e personit juridik	
Emri I personit juridik	
Adresa e personit juridik (vendi, rruga dhe numri)	
Numri personal ose një numër tjetër regjistrimi	
Numri tatimor I personit juridik	
Emri dhe mbiemri, telefoni dhe email kontakti	

II. Kërkesë për mbylljen e llogarisë pagesore nr.
--

III.	Udhëzimet për kthimin e fondeve që mbeten gjatë mbylljes së llogarisë pagesore
	-llogaria:
	-llogaria e të ardhurave:
	-programi:

Data_____ 20____.

(vulë dhe nenshkrimi I personit të autorizuar për përfaqsimin e personit juridik)

Formulari:BPRMV